

SONILA BOÇI**NGJARJET E VITIT 1990: SHTETI KOMUNIST SHQIPTAR
PËRBALLË FUNDIT TË PASHMANGSHËM***

“Këshilli i Ministrave të RDGJ-së (Republikës Demokratike Gjermane) me rekomandim të Byrosë Politike, ka vendosur që qytetarët e RDGJ mund të shkojnë në Republikën Federale dhe në Berlinin Perëndimor me banim të përhershëm apo për vizitë të përkohshme private pa marrë rrugën indirekte nëpërmjet vendeve të tjera, si Hungari, Poloni apo Çekosllovakia”¹. Ky ishte njoftimi që do të botohej në *Zërin e Popullit*, organ i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) të nesërmen e shembjes së Murit të Berlinit, më 10 nëntor 1989.

Po me këtë gjuhë lakonike dhe duke dhënë sa më pak detaje do të jepeshin dhe lajmet për rënien e komunizmit në Poloni, Çekosllovakia, Bullgari e Rumani. Megjithatë shqiptarët u informuan për revolucionet në Evropën e Lindjes Komuniste nëpërmjet medieve të huaja, si me pamjet ngazëlluese të shembjes së Murit të Berlinit, por edhe me ato makabre të revolucionit në Rumani. Era e ndryshimeve kishte përfshirë Lindjen, por në Shqipëri ende nuk po ndjehej asgjë.

Në pamje të parë, viti 1990 filloi ashtu si çdo vit tjetër për Shqipërinë. Në urimin zyrtar me rastin e festës së fundvitit, Ramiz Alia, atëkohë Sekretar i Parë i PPSH dhe Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, do ta konsideronte vitin 1989 si vitin më të suksesshëm të pesëvjeçarit VIII dhe do t’u kujtonte shqiptarëve se “gjatë 45 vjetëve të jetës së lirë çdo vit kishte qenë më i begatë se ai i mëparshmi. I tillë do të jetë edhe ‘90’². Ngjarjet e ndodhura në Evropën Lindore, sipas Alisë, nuk ishin surprizë, por një përfundim i pritshëm i politikave që drejtuesit

* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore "Nga komunizmi në demokraci: tranzicioni shqiptar", organizuar nga Instituti i Historisë i Qendrës së Studimeve Albanologjike, në kuadër të "Ditëve të Albanologjisë", Tiranë, më 22 dhjetor 2015.

¹ “Rregulla të reja për udhëtimet e qytetarëve të RDGJ në Republikën Federale dhe në Berlinin Perëndimor”, në *Zëri i Popullit*, 10 nëntor 1989, f. 4.

² “Vija e Partisë – vijë e lirisë, sovranitetit të plotë kombëtar e popullor”, në *Zëri i Popullit*, 1 janar 1990, nr. 1.

politikë të këtyre vendeve kishin ndjekur deri në atë kohë. Shqipëria nuk kishte asnjë lidhje me ato që po ndodhnin në Lindje, pasi vija politike e ndjekur nga ajo “ishte përpunuar në Shqipëri nga vetë komunistët shqiptarë, me shokun Enver Hoxha në krye, ka qenë dhe është një vijë e drejtë, vija e lirisë dhe pavarësisë dhe e sovranitetit të plotë kombëtar e popullor, e pakushtëzuar nga fuqi ose organizma të huaja ... Prandaj si dje, sot dhe në të ardhmen do ta ndjekim atë me besnikëri”³.

Lajtmotivi se Shqipëria ishte një rast *sui generis* dhe nuk kishte lidhje me ngjarjet në Evropën Lindore u bë guaskë mbrojtëse për drejtuesit më të lartë të PPSH. Dhe nga këto deklarata zyrtare natyrshëm të lind pyetja: vërtet e besonin drejtuesit më të lartë të PPSH se do të mund ta mbanin pushtetin ende pas atyre që kishin ndodhur në Lindjen Komuniste? Në aspektin e brendshëm, Ramiz Alia e kishte të qartë gjendjen shumë të rënduar ekonomike në të cilën ndodhej vendi dhe se durimi i shqiptarëve ishte në limitet e tij. Informacionet periodike, gati të përjavshme nga Drejtoritë e Sigurimit të Shtetit flisnin për pakënaqësitë masive të shqiptarëve⁴. Ato nënvizonin se reagimet e njerëzve kishin të bënin me situatën e rënduar ekonomike dhe me mungesat e vazhdueshme të produkteve kryesore në tregun shqiptar, pra jo drejtpërdrejt me natyrën e regjimit. Për më shumë, raportet theksonin se ishte shtuar veprimtaria dhe shpresat e kundërshtarëve tradicionalë të regjimit për ndryshime të ngjashme me ato që ndodhën në Evropën Lindore e Qendrore, si dhe vinin në dukje se edhe një pjesë e madhe e rinisë shqiptare, veçanërisht të Tiranës kërkonin ndryshime⁵.

Shqipëria nuk po kalonte ditë të lehta edhe në kontekstin ndërkombëtar. Që prej vitit 1985, Tirana zyrtare ishte vënë në fokus të Perëndimit për situatën e të drejtave të njeriut në vend, duke i mëshuar veçanërisht lirive fetare. Nga fundi i viteve '80, shtetet perëndimore si Franca, RFGJ, Italia po shtonin presionin edhe në fushën ekonomike. Një

³ Po aty.

⁴ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme* (më tej: *AMPB*), Fondi (më tej: F.) Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Viti (më tej: V.) 1989, Dosja (më tej: D.) 286, fleta (më tej: fl. 18), Raport i Drejtorisë së Sigurimit mbi reagimet e popullit mbi ngjarjet e ndodhura në Evropën Lindore, 18 dhjetor 1989.

⁵ Rinia shqiptare e qyteteve kryesore si: Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër etj. kishte përfituar nga zbutja e censurës së regjimit për të njohur me anë të televizioneve italiane jetën në Evropën Perëndimore, madje duke marrë dhe një variant të zbukuruar të saj.

pjesë e tyre kishin filluar të refuzonin eksportet shqiptare për shkak të cilësisë së dobët të tyre dhe nga ana tjetër, me pretekste të ndryshme po vononin lidhjen e marrëveshjeve dhe kontratave për vitin 1990⁶. Qeveria shqiptare po vendosej përballë një bllokade të vërtetë ekonomike, nga e cila e kishte të pamundur të dilte me modelet e praktikave të vjetra të organizimit ekonomik, politik e social të vendit.

Ramiz Alia duhej të ishte naiv për të besuar se regjimi mund të vazhdonte të qëndronte në këmbë dhe ai, vetëm naiv nuk ishte. Pikërisht mospërputhja e asaj që Alia dëshironte me të vërtetë, pra ruajtjes së regjimit dhe pamundësisë reale të tij për të siguruar mbijetesën e tij, kushtëzoi veprimtarinë e drejtuesve politikë shqiptarë gjatë vitit 1990. Rrjedhimisht reformat e ndërmarra ishin gjysmake, të vonuara, të ndikuara nga situatat dhe jo paraprijëse të tyre.

Ngjarjet e Shkodrës të janarit 1990 ishin një gur prove për regjimin në shumë aspekte. Një qytet i mirënjohur për qëndrimin e tij të vazhdueshëm antikomunist, Shkodra ishte bërë prej kohësh baza e organizimeve antiqeveritare. Sipas Gjergj Livadhit, një prej pjesëmarrësve në këto ngjarje, grupet sportive të lagjeve ishin bazat mbështetëse të kësaj lëvizjeje dhe një promotor për bashkimin e njerëzve⁷. Në ditët e para të janarit, ky grup nismëtarësh kishin shpërndarë një sërë traktesh, me anë të së cilave ftonin njerëzit të mblidheshin në një demonstratë antiqeveritare më 11 janar 1990, e cila në të vërtetë nuk u realizua sipas parashikimit⁸. Ajo u zhvillua tre ditë më vonë, më 14 janar 1990, kur qindra qytetarë të Shkodrës pushtuan qendrën e qytetit duke hedhur parulla kundër Enver Hoxhës, madje kërkuan të rrëzonin edhe bustin e Stalinit që ndodhej përballë selisë së

⁶ Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), F. 14/Arkivi i Partisë (më tej: AP) organet udhëheqëse (më tej: OU), V. 1990, D. 1, fl. 25, Nga fjala e Ramiz Alisë në Plenumin IX të KQ të PPSH, 22 janar 1990.

⁷ Intervistë personale e autores me Gjergj Livadhin, një nga organizatorët e demonstratës së Shkodrës, 11-14 janar 1990, datë 14 tetor 2014.

⁸ 11 Janari, ishte festa zyrtare e cila përkujtonte shpalljen e Republikës Popullore të Shqipërisë, ose Festa e Republikës, siç quhej asokohe. Sipas dëshmitarëve të ngjarjes, organizatorët e demonstratave kishin vendosur të mos e respektonin festën zyrtare. Punëtorëve iu kërkua të shkonin në punë, si në çdo ditë të zakonshme. Në të vërtetë, një grup i vogël punëtorësh iu drejtuan qendrave të punës, por dyert e tyre i i gjetën të mbyllura me zinxhirë. Të irrituar punëtorët dolën në sheshin kryesor të qytetit, por numri i tyre mbeti i vogël dhe demonstrata nuk arriti të realizohej.

Komitetit të PPSH të qytetit të Shkodrës⁹. Regjimi iu përgjigj ngjarjeve në Shkodër me metodën e tij tradicionale: dhunë ndaj organizatorëve dhe terr informativ për pjesën tjetër të vendit. Madje drejtues të lartë të PPSH dhe të Frontit duke përfshirë edhe Foto Çamin*, Adil Çarçanin* e Nexhmije Hoxhën¹⁰ në raste të ndryshme mohuan publikisht të kishte ndodhur ndonjë demonstratë antiqeveritare në Shkodër.

Në mbrëmjen e 11 janarit mediet ndërkombëtare, veçanërisht ato italiane dhe jugosllave i bënë jehonë demonstratës së paralizuar të Shkodrës. Madje, komentet e tyre flisnin edhe për vrasje masive në rrugët e qytetit dhe vendosje të gjendjes së jashtëzakonshme nga ana e qeverisë¹¹. Kjo solli dy efekte negative për ngjarjet e Shkodrës: *së pari*, dekonspiroi planin e demonstratës, duke i dhënë mundësi organeve policore të arrestonin në mbrëmjen e 13 janarit 1990 shumë prej organizatorëve të saj¹²; dhe, *së dyti*, i krijoi hapësirë regjimit për t'i konsideruar zhvillimet e mëvonshme në Shqipëri, jo si lëvizje e brendshme e shqiptarëve, por si të nxitura nga agjenturat e huaja¹³.

Aspekti pozitiv i ngjarjeve të Shkodrës ishte se e kishin vënë mekanizmin në lëvizje si në planin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar. Vetëm dy ditë pas tyre, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Perez de Cuellar pranoi ftesën e qeverisë shqiptare për të vizituar Tiranën, ndërkohë një delegacion i Senatit italian, i kryesuar nga Giuglio Orlando zhvilloi një vizitë tre ditore në Shqipëri, vizitë e cila përfshiu edhe Shkodrën. Mbasi u kthye në Itali ai dha një intervistë për “La Repubblica” dhe një intervistë telefonike për “Associated Press”. Vetë

⁹ Intervistë personale e autores me Gjergj Livadhin, një nga organizatorët e demonstratës së Shkodrës, 11-14 janar 1990, datë 14 tetor 2014.

* Anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH.

* Kryetar i Këshillit të Ministrave dhe anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH.

¹⁰ Kryetare e Frontit Demokratik të Shqipërisë.

¹¹ *AQSH*, F. 14/AP (struktura), V. 1990, dokument i papërpunuar.

¹² Ramiz Alia në kujtimet e veta (për më tepër shih: Ramiz Alia, *Jeta ime*, Tiranë: Toena, 2010) flet vetëm për tre të ndaluar, ndërkohë që pjesëmarrësit në ato ngjarje flasin për një numër disa herë më të madh, madje japin dëshmi për një sjellje çnjerëzore të punonjësve të policisë, duke i akuzuar ata për vrasjen nën tortura të Rini Monajkos, një qytetar shkodran me origjinë austriake, i cili ishte një nga më aktivët në përgatitjen e demonstratave të Shkodrës. (Intervista personale të autores me Gjergj Livadhin, Ded Kasnecin, organizatorë të demonstratës së Shkodrës, 11-14 janar 1990, datë 14 tetor 2014).

¹³ Në kujtimet e tij Ramiz Alia akuzon agjenturën jugosllave për organizimin e ngjarjeve të Shkodrës. Për më tepër shih: R. Alia, *Jeta ime ...*, f. 336-337.

Orlando përgënjeshtroi zërat e medieve ndërkombëtare për situatë të jashtëzakonshme në Shqipëri, foli për reformat që qeveria shqiptare po ndërmernte, por theksoi se ndryshimet në orientimin politik të Shqipërisë ishin një perspektivë ende e largët¹⁴.

Në planin e brendshëm, rrjedhoja më e dukshme e ngjarjeve të Shkodrës ishte mbledhja e Plenumit IX të KQ të PPSH, më 22 janar 1990. Ai dëshmoi qartazi se Ramiz Alia e kishte kuptuar vështirësinë me të cilën po ndeshej regjimi në Shqipëri, por ende nuk ishte i gatshëm të bënte ndryshime të thella. Ai parashtrroi para anëtarëve të Plenumit disa teza shumë të rëndësishme si: nevojën për reformim të vetë PPSH duke kërkuar që organizatat t'i nënshtroheshin gjykimit të publikut; rishikimin e disa politikave ekonomike duke përfshirë edhe disa ndryshime në mekanizmin e ri ekonomik të parashtruar vetëm katër muaj më parë në Plenumin VIII; futjen e disa elementëve të iniciativës, konkurrencës së lirë dhe pronës private; rikonceptimin e politikës së jashtme të Shqipërisë duke kërkuar që të mos ishte ideologjia ajo që diktonte marrëdhëniet e vendit me Botën, por nevojat ekonomike e politike të tij; u parashtrua dhe nevoja për ndryshimin e Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale, duke prekur një sërë çështjesh që lidheshin me të drejtat e njeriut, duke i venë theksin lirive fetare¹⁵.

Me përjashtim të çështjeve që lidheshin me rolin e PPSH në jetën politike e shoqërore të vendit, si dhe reformave ekonomike, pjesa tjetër e problemeve të ngritura, u shtruan thjesht në parim pa kërkuar vendimmarrje për to. Lidërshipi komunist nuk kishte asnjë nxitim për të përshpejtuar reformat duke qëndruar në pritje të zhvillimeve të mëvonshme. Plenumi shtoi dhe çështjen e pluripartitizmit, por anëtarët e Plenumit të KQ të PPSH njëzëri e konsideruan atë si të papranueshëm, pasi dëmtonte kohezionin e shoqërisë shqiptare dhe ishte i papajtueshëm me traditën historike¹⁶. Qartazi drejtuesit komunistë ishin të vendosur për të mos lëshuar pe në çështjen e lëshimit, qoftë edhe të pjeshëm, të pushtetit.

¹⁴ "No sign of security crackdown in Albania, Italian senator says", in *Associated Press*, <http://www.apnewsarchive.com/1990/No-Sign-of-Security-Crackdown-in-Albania-Italian-Senator-Says/id-f56054a3c0b0c22ad2319ac010f6e621> (vizituar më 21 janar 2015).

¹⁵ *AQSH*, F. 14/AP, OU, V. 1990, D. 1, Nga fjala e Ramiz Alisë në Plenumin IX të KQ të PPSH, 22 janar 1990.

¹⁶ *Po aty*, Nga procesverbali i Plenumit IX të KQ të PPSH, 22 janar 1990.

Ramiz Alia, nxiti drejtuesit e lartë të KQ të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të përballeshin me opinionin e gjerë të shqiptarëve. Ai i detyroi ata të merrnin pjesë në një sërë emisionesh televizive, për të folur për reformat televizivë. Performanca politike dhe profesionale e tyre ishte e ulët dhe shumë shqiptarë u habitën dhe u zhgënjyen nga niveli i udhëheqësve të tyre. Ndërsa vetë, ashtu siç e kishte bërë traditë tashmë, zhvilloi takime të drejtpërdrejta me kategori të ndryshme të popullsisë për të diskutuar vendimet e Plenumit IX. Ai zhvilloi një takim me punëtorët e Kombinatit të Autotraktorëve në Tiranë si dhe me një grup nxënësish të shkollave të mesme dhe studentësh të Universitetit të Tiranës¹⁷. Takimet fokusoheshin vetëm në dy çështje: mbledhjet e hapura të organizatave të Partisë dhe forcimin e mekanizmit të ri ekonomik.

Ndërkohë që drejtuesit e PPSH ishin përfshirë zemërthyer dhe jo gjithmonë të qartë në realizimin e vendimeve të Plenumit IX, shtetin komunist e prisnin të tjera sfida. Ngjarjet ndërkombëtare por dhe ato brenda vendit rrokulliseshin me shpejtësi dhe ushtronin presion mbi shtetin komunist shqiptar për ndryshime të njëpasnjëshme. Më 6 mars 1990, Komisioni i të Drejtave të Njeriut i OKB miratoi një rezolutë për Shqipërinë, sipas së cilës kërkonte “informacione për mënyrën konkrete se si masat ligjore dhe kushtetuese janë në përputhje me dispozitat e Deklaratës Universale të të drejtave të Njeriut”, duke theksuar madje që Sekretari i Përgjithshëm i OKB-se ta kishte parasysh këtë rezolutë gjatë vizitës së planifikuar në Shqipëri në maj 1990. Brenda vendit një tjetër ngjarje tronditi qetësinë e drejtuesve të regjimit. Këtë radhë ishte Kavaja, qyteti që do të shfaqte hapur kundërshtimin e tij ndaj regjimit. Më 25 mars 1990, gjatë ndeshjes së futbollit Besa-Partizani, në minutën 80 të saj, një spektator hodhi në fushë një libër të Enver Hoxhës, ndërsa turma qëlloi me gurë mbi policinë që kishte kapur një djalë të ri. Pas ndeshjes rreth 200 të rinj u përleshën me policinë. Gjatë asaj nate policia ndaloi një numër të madh njerëzish, të cilët, sipas të dhënave, u keqtrajtuuan gjatë marrjes në pyetje. Një ditë më vonë, një grup të rinjsh dolën sërish në shesh duke kërkuar lirimin e shokëve të ndaluar një ditë më parë. Ata marshuan drejt Komitetit të Partisë së Kavajës dhe Rajonit të Policisë, duke hedhur sërish gurë mbi policët¹⁸.

¹⁷ “Përparimi i vendit kërkon dije, kulturë dhe krijimtari, shoku Ramiz Alia u takua me një grup të rinjsh të shkollave të mesme dhe universitare”, në *Bashkimi*, 11 mars 1990.

¹⁸ Fred C. Abrahams, *Shqipëria e Re, nga diktatura në demokraci*, Tiranë: Dudaj, 2015, f. 58-59.

Ashtu si dhe për ngjarjet e Shkodrës, shtypi zyrtar nuk shkroi as një fjalë. Gjithsesi, ngjarja kishte ndikuar që regjimi të detyrohej për të bërë lëshimin e radhës. Në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH të 26 marsit 1990, Alia do t'u drejtohej kolegëve të tij: "Armiqtë tanë duan përmbysje të pushtetit popullor, pra është vënë në shenjë liria dhe pavarësia e atdheut tonë. Edhe çështja e të drejtave të njeriut dhe të demokracisë, borgjezia po i përdor si instrumente për të goditur lirinë dhe pavarësinë kombëtare"¹⁹. Ai ftone anëtarët e tjerë të Byrosë Politike që të pranenin disa lëshime në mënyrë që të ruanin shtyllat kryesore të regjimit: "çështja e lirisë dhe e pavarësisë kombëtare, çështja e rolit udhëheqës të Partisë, çështja e pushtetit të popullit dhe e pronës shoqërore"²⁰. Më 12 prill 1990, anëtarët e Byrosë Politike shqyrtuan dhe miratuan një varg rregullimesh në legjislacionin shqiptar të tilla si: vendimin për lëshimin e pasaportave për të gjithë shtetasit shqiptarë që dëshironin të udhëtonin jashtë shtetit, ndryshimet në Kodin Penal dhe të Procedurës Penale; rihapjen e Ministrisë së Drejtësisë; rivendosjen e sistemit të avokatisë, abrogimi i internim-dëbimit si masë administrative, riorganizimin e gjykatave, futjen e konceptit të faljes së dënimit për sjellje të mirë (vetëm për personat që kishin kryer krime ordinere) etj.²¹ Shumë diskutime dhe kundërshtime patën veçanërisht dy nene të Kodit Penal: abrogimi i nenit 55 për agjitacionin dhe propagandën; si dhe ndryshimi i nenit që e konsideronte arratisjen jashtë vendit si krim kundër shtetit. Largimi nga vendi do të konsiderohej, tash e tutje, si kalim i paligjshëm i kufirit dhe do të ndëshkohej me masa administrative²². Anëtarëve të Plenumit iu kërkua që një pjesë e këtyre ndryshimeve, veçanërisht ato të Kodit Penal të mos bëheshin publike, për shkak të nevojave procedurale.

Në të vërtetë, vendimmarrja i takonte Kuvendit Popullor. Por më shumë se respektimi i procedurave, arsytet duhen kërkuar në lojërat politike të drejtuesve të lartë komunistë. Ramiz Alia kishte kohë që po përpiqej t'i paraqitej opinionit publik si Gorbaçovi shqiptar, i cili po

¹⁹ *AQSH*, F. 14/AP, OU, V. 1990, D. 46, fl. 47, Nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, 19 dhe 26 mars 1990.

²⁰ *Po aty*, Nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, 19 dhe 26 mars 1990.

²¹ *Po aty*, F. 14/AP, OU, V. 1990, D. 10, Nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike, dt. 12 prill 1990.

²² *Po aty*, Nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike, dt. 12 prill 1990

kërkonte të reformonte vendin në një përballje të fortë me krahun konservator të PPSH. Në të vërtetë, ndjehej hezitimi i drejtuesve të lartë komunistë në lidhje me reformat e ndërmarra nga Ramiz Alia. Sipas informacioneve që vinin nga rrethet, shumë prej komunistëve ishin konfuzë dhe të paqartë për reformat, ndërsa kishte të tjerë që shihnin ngjashmëri ndërmjet propozimeve të Alisë me projektet e paraqitura në fillim të viteve '70 nga ish-drejtuesit e dënuar të ekonomisë: Koço Theodhosit, Kiço Ngjelës etj. Por, në një shoqëri të mësuar të ndjekë urdhrat e njëshit, nuk kishte rrezik për Ramiz Alinë që situata t'i dilte jashtë kontrollit.

Alia përpiqej të luante me dy porta: nga njëra anë, të nxiste ndryshimet dhe mbështeste reformat, nga të cilat pritej përmirësim i gjendjes ekonomike, por edhe ulja e pakënaqësisë së njerëzve. Nga ana tjetër, kërkonte të mbante të mobilizuar komunistët konservatorë. Në një plan më të gjerë, Alia kërkonte të paraqitej para opinionit ndërkombëtar si njeriu që dëshiron të ndryshojë gjërat, por që has vështirësi të shumta nga konservatorët²³. Pranimi i ndryshimeve në fushën e të drejtave të njeriut ishte një hap i madh për regjimin dhe realisht prekte thelbin e tij. Nga ana tjetër, Alia e kuptonte se nuk mund të rezistonte më gjatë pa kryer këto ndryshime. Ai i paraqiti reformat për të drejtat e njeriut para opinionit të brendshëm si të bëra nën presionin ndërkombëtar dhe rrethanave aktuale. Është pikërisht kjo arsyeja që vendimet e marra në Byronë Politike, më 12 prill, për të lehtësuar situatën e të drejtave të njeriut në vend, iu paraqitën opinionit publik shqiptar pas vizitës së Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, Perez De Cuelar, në Shqipëri, më 12-14 maj 1990. Këtu u përfshi edhe zgjidhja e çështjes së familjes Popaj, të strehuar në ambasadën italiane që prej dhjetorit 1985.

Njëkohësisht me ndryshimet në legjislacion, opinioni filloi të orientohej drejt pranimit të idesë së pluralizmit të mendimit, duke anashkaluar të flitej për temën më të rëndësishme që ishte pluralizmi partiak. Në shtypin e përditshëm u lejua botimi i disa artikujve që shprehnin mendime jo në përputhje të plotë me ato zyrtare, siç ishte p.sh. intervista e Ismail Kadaresë e 21 marsit 1990 në gazetën *Zëri i Rinisë* dhe

²³ Perëndimi ishte shokuar nga pamjet makabre të “revolucionit” rumun dhe ekzekutimin publik të bashkëshortëve Çausheku. Ata nuk dëshironin që pamje të tilla të përsëriteshin. Ramiz Alia duke kuptuar frikën e Perëndimit, në takimet e zhvilluara gjatë vitit 1990 shtronte nevojën e ndryshimeve graduale, pasi situata në Shqipëri nuk ishte ende e gatshme për ndryshime të thella.

artikulli i prof. Ylli Popës, “Në kërkim të kohës së humbur”, botuar më 28-29 prill 1990 në gazetën *Zëri i Popullit*²⁴. Idenë e pluralizmit të mendimit, Ramiz Alia e parashtrroi zyrtarisht në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik, të mbledhur më 5 qershor 1990. Ai u shpreh se Fronti Demokratik dhe të gjithë organizatat e masave nuk kishin përse të konsideroheshin si “leva” apo “rripa transmissioni” të vendimeve të PPSH. Fronti duhet të shndërrohej në një tribunë e masave, e cila nuk kishte pse të ishte në unison. “Fronti ekziston, - thoshte Ramiz Alia, - që t’i dëgjojë zërat e ndryshëm e t’i harmonizojë ato nëpërmjet debatit, kritikës dhe autokritikës, konfrontimit të ideve e të vendimeve, analizës e sintezës, logjikës së shëndoshë e interesit të përgjithshëm”²⁵.

Ndërsa, deri në mesin e vitit '90 dukej sikur regjimi kishte arritur ta mbante nën kontroll situatën dhe, të paktën në dukje, t’u imponohej shqiptarëve, gjysma e dytë e viteve '90 flet për një situatë krejt tjetër. Korriku do të ishte një muaj djegës për qeverinë shqiptare dhe kjo jo vetëm për shkak të temperaturave të larta, sidomos për shkak të ngjarjeve që do ta nxirrnin regjimin të zhveshur si para opinionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Ngjarjet e ambasadave që filluan në fund të qershorit 1990 dhe do të merrnin përmasa të gjera në datat 2-4 korrik ishin ato më diskreditueset, por jo të vetmet. Në mbremjen e 10 korrikut 1990, policia gjatë përpjekjes për të shpërndarë me dhunë protestën e një grupi të rinjsh në qytetin e Kavajës, vrau Josif Budon, një djalosh 21-vjeçar dhe plagosi vëllanë e tij. Të nesërmen, varrimi i 21-vjeçarit u shndërrua në një manifestim të fuqishëm proteste, në të cilin, sipas njoftimeve të autoriteteve partiake, merrte pjesë i gjithë qyteti, madje edhe komunistët²⁶.

Regjimi arriti ta mbajë sërish të fshehtë për publikun ngjarjen e Kavajës, por ai nuk mundi t’i shpëtonte turpit të ngjarjeve të ambasadave. Hyrja e gati 5000 vetave në selitë e pothuajse të gjitha ambasadave perëndimore të akredituara në Tiranë ishte "kovë me ujë të ftohtë" jo vetëm për regjimin në Shqipëri, por edhe për gjithë procesin e reformave që kishte ndërmarrë R. Alia. Në planin ndërkombëtar, ajo hidhte poshtë propagandën zyrtare se situata ekonomike po përmirësohej dhe pakënaqësitë e shqiptarëve nuk drejtoheshin ndaj regjimit. Ajo shërbeu që opinionin ndërkombëtar të njihet nga afër me varfërinë e thellë në të

²⁴ F. C. Abrahams, *Shqipëria e Re ...*, f. 60.

²⁵ “U mbledh Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Demokratik, tribunë e mendimit të lirë të masave”, në *Zëri i Popullit*, 6 qershor 1990.

²⁶ *AQSH*, F. 14/AP (struktura) V. 1990, dokument i papërpunuar.

cilën jetonin shqiptarët. Në planin e brendshëm, ngjarjet e ambasadave treguan për pafuqinë dhe rrënimin e shtetit. Diplomatët italianë tregonin se në disa raste ishin policët ata që i ndihmonin njerëzit të ngjisnin muret e ambasadave²⁷.

Në të vërtetë, ishte dëshpërimi dhe mungesa e shpresës që i shtynte shqiptarët të largoheshin me çdo mënyrë nga vendi i tyre. Në ditët e fundit të korrikut, Tirana “do të mësyhej” nga grupe njerëzish të cilët kërkonin të hynin me çdo kusht në ambasadat tashmë të mbyllura dhe pa personel²⁸. Pikërisht në këtë kohë, policia arrestoi gati 150 qytetarë shqiptarë²⁹. Në pamundësi për të mbajtur rendin, dhuna policore vërshoi rrugëve të qytetit, gjë që rriti edhe më shumë pakënaqësinë e popullsisë ndaj regjimit.

Krahas dhunës, regjimi iu përgjigj situatave me metodat e njohura populiste. Një miting madhështor u organizua në sheshin Skënderbej, si kundërpërgjigje ndaj ngjarjeve së ambasadave. Mitingu dallohej për masivitetin e pjesëmarrësve, por jo për entuziazmin e tyre. Ndërsa, gjatë muajit gusht, Alia zhvilloi një sërë takimesh me kategori të ndryshme njerëzish në përpjekje për të analizuar ngjarjet dhe për të gjetur zgjidhje, por edhe të përligjte mungesën e suksesit të reformave. Në ato takime, vihej re konfuzioni në të cilin ndodhej ai si drejtues.

Në takimet me drejtues të MPB kërkonte që strukturat e Sigurimit të Shtetit të vazhdonin punën e tyre për të gjurmuar opinionet e publikut³⁰ dhe drejtuesve të Ministrisë së Mbrojtjes u kërkonte të ishin të gatshëm t’u përgjigjeshin situatave që mund të vinin. Ndërsa një tjetër qëndrim mbajti Alia në takimin me intelektualët. Takimi ishte thirrur, mesa duket, për t’i kërkuar mbështetje elitës intelektuale ndaj regjimit dhe për të kompensuar dhe kundërbalancuar propagandën antikomuniste që kishte shpërthyer në Shkodër, Kavajë, Tiranë e Vlorë.

Takimi rezultoi jo plotësisht i suksesshëm për Ramiz Alinë, por ai nuk ishte një lajm i mirë edhe për shqiptarët. Alia u gjend para kritikave të intelektualëve për mungesën e informimit për situatat që po kalonte vendi dhe për sjelljen brutale të policisë. Alia, nga ana tjetër, arriti t’i

²⁷ Antonio Varsori, “Italy and the end of communism in Albania”, in *Cold War History*, 12:4, 2012, p. 615-635.

²⁸ AQSH, F. 14/AP (struktura), V. 1990, dokumente të pasistemuara, Raport i Degës së Brendshme të Tiranës, mbi ngjarjet e ndodhura në qytet, 25 korrik 1990.

²⁹ *Po aty*.

³⁰ *Po aty*, Takim i Ramiz Alisë me drejtues të lartë të MPB, 17 gusht 1990.

intimidonte intelektualët për të mos u shprehur hapur në mbështetje të pluralizmit politik. Megjithëse kishte të guximshëm si Napolon Roshi që kërkuan ndryshimin e kuadrit ligjor në mënyrë që krijimi i partive të tjera të mos ndalohej me ligj, apo më të kamufluar që kërkonin një pluralizëm politik brenda llojit³¹.

Vjeshta nxori edhe më në pah degradimin ekonomik të Shqipërisë dhe paaftësinë e regjimit për t'u përballur me situatat. Mekanizmi i ri ekonomik po dështonte, ekonomia shqiptare jo vetëm nuk po dilte nga kriza, por ajo po thellohej edhe më shumë. Presioni i ndërkombëtarëve, sa vinte dhe shtohej. Personeli i ambasadave kryesore perëndimore ishin larguar pas krizës së ambasadave dhe po refuzonin me pretekste të ndryshme të ktheheshin. Shteti po rrënohej dita-ditës dhe alternativat për shpëtim brenda vendit mungonin. Regjimi kishte filluar të kishte frikë nga qytetarët. Më 24 gusht 1990, në një mbledhje të sekretarëve të KQ të PPSH, Alia kërkoi të merren të gjitha masat për kthimin nga pushimet e verës të studentëve në Tiranë³². Frika e tij ishte e qartë: kundërshtitë e hapura ndaj regjimit në qytetet e ndryshme të vendit do të pushtonin kryeqytetin me ardhjen e studentëve dhe do t'i bashkoheshin pakënaqësive të heshtura të banorëve të tij.

Fundi i vitit '90 nuk reflektonte aspak qetësinë me të cilin kishte filluar. Një pjesë e madhe e reformave ekonomike të ndërmarra përgjatë atij viti rezultuan jo të suksesshme, madje dhe të paaplikueshme për shkak të mungesave si në legjislacion, ashtu edhe në specialistë. Sipas raporteve që vinin nga rrethet, vjedhjet dhe grabitjet ishin bërë masive. Dëshpërimi dhe mungesa e perspektivës ishin kryefjala e ditës. Në këtë situatë, Alia mori një tjetër iniciativë. Më 6-7 nëntor 1990, në Plenumin XI, ai parashtriu nevojën për të rishikuar ligjin e zgjedhjeve dhe për të bërë disa ndryshime në Kushtetutën e vendit. Ndryshimet kishin të bënin me detyrimin ligjor për të ruajtur fshehtësinë e votës dhe konkurrimit në zgjedhje të disa kandidatëve. Përveç kandidatëve të Frontit Demokratik do të lejoheshin edhe organizatat e tjera të masave, si: Bashkimi i Grave të Shqipërisë (BGSH), Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë (BRPSH), Bashkimet Profesionale (BP) etj., do të mund të propozonin

³¹ *Po aty*, Fjala e Ismail Lleshit në takimin e Ramiz Alisë me intelektualët e qytetit të Tiranës, 11 gusht 1990.

³² *Po aty*, F. 14/AP, OU, V. 1990, D. 48, fl. 26, Mbledhje e Ramiz Alisë me sekretarët e KQ të PPSH, mbi masat që duhen marrë për punën me rininë studentore, 24 gusht 1990.

kandidatët e tyre. Propozimet për ndryshime në Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (RPSSH) i hiqnin PPSH-së rolin udhëheqës në jetën e vendit. Ateizmi si ideologjia e vetme në vend nuk do ta gëzonte më këtë status, që do të thoshte lejimin e feve. Efekti i menjëhershëm i këtyre masave ishte mbajtja e një meshe katolike në Shkodër, e cila u shndërrua në një miting të vërtetë popullor. Këto ndryshime, në dukje, të mëdha për PPSH-në sërish nuk preknin thelbin e sistemit dhe nuk flisnin për ndonjë ndryshim kursi. Regjimi thjesht kishte pranuar një lloj pluralizmi brenda llojit, i cili i shkonte për shtat idesë së Alisë për pluralizmin e mendimit.

Kjo ishte situata e përgjithshme në Shqipëri, kur filloi lëvizja studentore. Një situatë e mbushur me pakënaqësi dhe dilema. Mbrëmjen e 8 dhjetorit, studentët e Universitetit të Tiranës protestuan kundër qeverisë, fillimisht për kushtet e vështira në Qytetin Studenti, por shpejt protesta e tyre do të merrte rrugën e duhur, atë të kërkesës për lejimin e pluralizmit politik dhe rënien e sistemit me sloganin “E duam Shqipërinë si gjithë Evropa”. Shteti i cili nuk kishte as vullnet as forcë për t’i rezistuar lëvizjes studentore, bëri të vetmen lëvizje që shmangu një përplasje civile ndërmjet vetë shqiptarëve, lejoi krijimin e pluripartitizmit. Fitorja më e madhe e studentëve ishte padyshim shpallja e pluralizmit politik dhe krijimi i partisë së parë opozitare, Partisë Demokratike, ngjarje të cilat i hapën rrugë tranzicionit shqiptar për në demokraci.

Si përfundim, ngjarjet e ndodhura përgjatë vitit 1990 në Shqipëri ishin padyshim reflektim i gjendjes ndërkombëtare dhe ndryshimeve të ndodhura në Lindje, por ato flasin shumë për atë çka ishte shoqëria shqiptare e atyre viteve. Një shoqëri e cila jetonte mes privimesh të shumta ekonomike e politike, por që ishte e indoktrinuar dhe e frikësuar në atë pikë sa nuk guxonte të reagoje, apo më keq akoma trembej nga vetë ndryshimi. Shtypja e vazhdueshme shtetërore kishte sjellë mungesën e një lëvizjeje të organizuar disidente. Si pasojë e kësaj, pjesa më e madhe e shqiptarëve nuk e kishin idenë se çfarë përfaqësonte demokracia liberale. Të mësuar me një kontroll të skajshëm shtetëror, liria nuk u pa si përgjegjësi e shtuar individuale, por si thirrje për anarki e cila pasoi vitin 1991. Ndërsa ndryshimet demokratike arritën të bëheshin pa kosto të shumta njerëzore, dhe kjo ishte një fitore e madhe, kostoja materiale e këtyre ndryshimeve ishte shumë e lartë dhe e parikuperueshme për vendin.